



UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
"HASAN PRISHTINA"  
UNIVERSITY OF PRISTINA

FAKULTETI I NDËRTIMTARISË – CIVIL ENGINEERING FACULTY

Rr. Agim Ramadani, ndertesa e "Fakultetit Teknik", 10000 Prishtinë, Kosovë

Tel: +383-38-548 644

URL: <http://www.fna.uni-pr.edu>

Mail: [fn@uni-pr.edu](mailto:fn@uni-pr.edu)

Ref. nr. 3704/1 Prishtinë 31.10. 2022

**PUBLIKIMI I ABSTRAKTIT TË PUNIMIT TË DIPLOMËS MASTER**

**DEPARTAMENTI HIDROTEKNIK**

Studenti Adelina Ahmetaj ka dorëzuar dorëshkrimin e punimit të diplomës Master me titull: “ **Hydrocentralet e vogladhe studimi mbi rehabilitimin e HCV Burim** ” në programin e studimeve Master Konstruktiv dhe dorëshkrimi është në procedurë të vlerësimit përfundimtar deri në vendimin e këshillit të Fakultetit të Ndërtimtarisë. Sipas rregullores për studimet Master Shkencor të Universitetit të Prishtinës, abstrakti i shkurtër i punimit të diplomës bëhet publik për periudhën kohore prej pesë ditësh nga dita e shpalljes.

## Abstrakt

ABSTRAKTI Punim hulumtues me titullin “ Hydrocentralet e vogla dhe studimi mbi rehabilitimin e HCV Burimit”, qëllimi i këtij hulumtimi ka të bëjë me rehabilitimin e hidrocentralit. Që nga fundi i shekullit të 19-të, hidrocentrali është zhvilluar si një burim i pastër, i sigurt, i besueshëm dhe i lirë i energjisë dhe shërbimit të energjisë. Hydrocentralet bëjnë shëndërrimin e energjisë potenciale të rëniës së ujit në energjinë mekanike me anë të turbinës hidraulike dhe pastaj gjeneratori shndërron energjinë mekanike në atë elektrike. Qëllimi i studimit ka të bëjë me analizën e mundësisë së rehabilitimit dhe vlerësimit të funksionit të hidrocentralit i cili ishte jashtë funksionit. Hulumtimi është ndarë në dy pjesë ku pjesa e parë ka të bëjë me gjendjen ekzistuese të hidrocentralit, gjetjen e të dhënave nga aspekti gjeografik, gjeologjik, hidrologjik dhe literaturën e hidrocentralit, ndërsa pjesa e dytë ka të bëjë me rehabilitimin e hidrocentralit, rritjen e kapacitetit të turbinave gjithashtu dhe shpenzimet e arritjes së rehabilitimit. Duke pasur parasysh që hidrocentrali ishte në funksion disa vite dhe kishte një kapacitet të knaqshëm, tani është jashtë funksionit dhe duke pasur parasysh që vendi ynë përballë me mungesë të energjisë, është bërë nevoja e rehabilitimit të hidrocentralit i cili ishte jashtë funksionit për disa vite gjithashtu të bëhet edhe rritjen e kapacitetit të turbinave. Rezultate të arritura nga ky hulumtim është arritur që të vihet në funksion hidrocentrali gjithashtu të bëhet edhe rritja e kapacitetit të furnizimit të energjisë elektrike.

Dorëshkrimi i punimit është i atashuar në sekretarinë e Fakultetit të Ndërtimtarisë dhe është i qasshëm për publikun. Çdo vërejtje, plotësim, ndryshim mund të deponohet me shkrim i protokolluar dhe do të merret për trajtim nga këshilli i Fakultetit të Ndërtimtarisë.